I

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia e Qytetit Krujë
Këshilli i Bashkisë

VENDIM

Nr 50 Datë 31.08.2015

Për

Per miratimin e ndryshimit të aksionerit te Ujësjellës- Kanalizime sh.a. Fushë – Krujë nga Bashkia Fushë-Krujë në Bashkinë Krujë dhe autorizimin e Z. Artur Bushi për të përfaqsuar Këshillin e Bashkisë Krujë në Asamblenë e Aksionerëve të Ujësjellës- Kanalizime sh.a. Fushë –Krujë

Këshilli i Bashkisë Krujë, në mbledhjen e tij të datës 31.08.2015, pasi mori në shqyrtim materjalin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë , mbështetur në ligjin 8652 të datës 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar neni 32 , ligji nr 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar :

VENDOSI

1. Të Miratimin e ndryshimit të aksionerit të Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizime sh.a.Fushë- Krujë nga Bashkia e qytetit Fushë Krujë , në Bashkinë Krujë me 100% të aksioneve të sh.a.-se.

2. Të miratojë autorizimin e Z. Artur Bushi për të përfaqsuar Këshillin e Bashkisë Krujë në Asamblenë e Aksionerëve të Ndërmarrjes së Ujësjellës- Kanalizime sh.a. Fushë-Krujë

3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit për bazueshmëri ligjore nga Prefekti i Qarkut të Durrësit.

Kryetari i Këshillit

Hysni Caca

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA **"UJESJELLES KANALIZUME SHA" KRUJE**
Adresa : KRUJE, **Shqiperi**
NIPT : **J64713209 J**

VENDIM I PERFAQESUESIT LIGJOR TE SHOQERISE

Datë 30.01.2017

Në selinë e shoqërisë "UJESJELLES KANALIZIME SHA" KRUJE , sot, më datë, 30.01.2017, Perfaqesuesi i ligjor i shoqerise :

- Z. Ledio Cela , i lindur me date 17.02.1971 ne Burizane, Kruje, Shqiperi, banues ne adresen : Rr Burizane, Fushe Kruje, Shqiperi, me shtetesi shqiptare, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjoftimit ID Nr. H710217082Q e leshuar ne date 27.05.2010.

Duke u bazuar ne **VKM 63 dt 27.01.2016 " Ligji 139/2015 Per vetqeverisjen vendore , Ligji 9723 dt 3.05.2007 "Per qendren Kombetare te Biznesit (I ndryshuar) , ligjit 115/2014 Per ndarjen administrative teritoriale te njesive te qeverisjes vendore , Vendimi i keshillit Bashkiak Kruje nr 51 dt 31.08.2016 ." Per miratimin e ndryshimeve te Aksioneve te Ujesjelles –Kanalizimeve sha Kruje.**

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për bashkimin me përthithje te shoqërisë **"UJESJELLES KANALIZUME SHA" KRUJE me NUIS J64713209J** me shoqërinë **"UJESJELLES KANALIZIME FUSHE KRUJE " sha me NUIS J93711212U** sipas akteve të bashkimit dhe projektit të bashkimit të shoqërive.
2. Emërimin e ekspertit kontabël te autorizuar **Znj. Silvana Gjikdhima**, me licence profesionale nr.162 date 25/01/2007 dhe **znj Vullnetare Cela (Hoxha)** me licence profesionale nr 153 për te hartuar raportin e bashkimit sipas kërkesave te të Ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare".
3. Te depozitohet ky vendim i Perfaqesuesit ligjor ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit, së bashku me aktet e tjera që e shoqërojnë.
4. Autorizohet Znj.Erinda Seferi me ID I25817186B te beje depozitimin e dokumenteve ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit.

PERFAQESUESI LIGJOR	**KRYETARI I BASHKISE**
Emri : Ledio Cela	**Artur BUSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “UJESJELLES KANALIZIME FUSHE KRUJE “ sha
Adresa : FUSHE KRUJE QENDER
NIPT : **J93711212U**

VENDIM I PERFAQESUESIT LIGJOR TE SHOQERISE
Datë 30.01.2017

Në selinë e shoqërisë “UJESJELLES KANALIZUME FUSHE KRUJE” SHA , sot, më datë, 30.01.2017, Perfaqesuesi i ligjor i shoqerise :

- Z. Xhemali Xhixha i lindur me date 11.01.1961 ne Arrameras , Kruje, Shqiperi, banues ne adresen : Arrameras Fushe Kruje, Shqiperi, me shtetesi shqiptare, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjoftimit ID Nr. G10111038M e leshuar ne date 13.04.2010.

Duke u bazuar ne **VKM 63 dt 27.01.2016 “ Ligji 139/2015 Per vetqeverisjen vendore , Ligji 9723 dt 3.05.2007 “Per qendren Kombetare te Biznesit (I ndryshuar) , ligjit 115/2014 Per ndarjen administrative teritoriale te njesive te qeverisjes vendore , Vendimi i keshillit Bashkiak Kruje nr 51 dt 31.08.2016 .“ Per miratimin e ndryshimeve te Aksioneve te Ujesjelles –Kanalizimeve sha Kruje.**

VENDOSI:

5. Fillimin e procedurës për bashkimin me përthithje te shoqërisë **“UJESJELLES KANALIZUME SHA” KRUJE me NUIS J64713209J** me shoqërinë **“UJESJELLES KANALIZIME FUSHE KRUJE “ sha me NUIS J93711212U** sipas akteve të bashkimit dhe projektit të bashkimit të shoqërive.
6. Emërimin e ekspertit kontabël te autorizuar **Znj. Silvana Gjikdhima**, me licence profesionale nr.162 date 25/01/2007 dhe **znj Vullnetare Cela (Hoxha)** me licence profesionale nr 153 për te hartuar raportin e bashkimit sipas kërkesave te të Ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”.
7. Te depozitohet ky vendim i Perfaqesuesit ligjor ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit, së bashku me aktet e tjera që e shoqërojnë.
8. Autorizohet Z Erinda Seferi me ID I25817186B te beje depozitimin e dokumenteve ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit.

PERFAQESUESI LIGJOR

Xhemali Xhixha

KRYETARI I BASHKISE

Artur BUSHI

PROJEKT MARRËVESHJE PËR BASHKIM ME PËRTHITHJE TE
"UJESJELLES KANALIZIME SHA FUSHE KRUJE nga "UJESJELLES
KANALIZIME SHA KRUJE "

Ledio Cela ,Perfaqesuesi ligjor i shoqërisë **"UJESJELLES KANALIZIME SHA KRUJE "** me NUIS (NIPT) J64713209J me objekt ;

shitje ujit te pijshem dhe kanalizime,

dhe

Xhemali Xhixha Perfaqesuesi ligjor i shoqërisë **"UJESJELLES KANALIZIME SHA FUSHE KRUJE** me NUIS (NIPT) J937111212U, me objekt ;

Sherbimi i furnizomit me uje te pijshem dhe shitja e tij.Mirembajtja e sistemeve te furnizimit me uje te pijshem.
Prodhimi ose blerja e ujit per plotesimin e kerkesave te konsumatoreve.Sherbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit te ujrave te ndotura. Mirembajtja e sistemit te ujrave te ndotura si edhe impiantev ete pastrimit te tyre.
Shoqeria mund te realizoje cdo lloj operacioni tregtar apo financiar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj brenda limiteve qe percakton legjistacioni ne fuqi. Shoqeria do te kryej cdo veprim me qellim marjen e lejeve ,licencave , autorizimeve dhe miratimeve te nevojshme per realizimin e veprimtarise se saj per te cilat kerkohen keto akte administrative

pas një vendimi paraprak dhe bazuar ne dispozitat e Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", neni 216, përpilojnë këtë marrëveshje për bashkim të shoqërive me përthithje, ku shoqëria përthithëse është shoqëria **"UJESJELLES KANALIZIME SHA KRUJE "** dhe shoqëria e përthithur **"UJESJELLES KANALIZIME SHA FUSHE KRUJE**

Administrator i shoqërisë perthithese, **"UJESJELLES KANALIZIME SHA KRUJE "** do te jete . *Ledio Cela , i lindur me date 17.02.1971 ne Burizane, Kruje, Shqiperi, banues ne adresen : Rr Burizane, Fushe Kruje, Shqiperi, me shtetesi shqiptare, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjoftimit ID Nr. H710217082Q e leshuar ne date 27.05.2010.*

- Për modalitetet e bashkimit të dy shoqërive do të përpilojme një raport të përbashkët, i cili do të depozitohet rregullisht.

Emërohet eksperte kontabël i autorizuar për përgatitjen e raportit dhe modaliteteve për vlerësimin e kushteve të marrëveshjes së bashkimit me përthithje të shoqërisë **“UJESJELLES KANALIZIME SHA KRUJE** dhe shoqërise **“UJESJELLES KANALIZIME SHA FUSHE KRUJE,** ku *shoqëria përthithëse* është shoqëria **“UJESJELLES KANALIZIME SHA KRUJE”** dhe *shoqëria e përthithur* eshte shoqëria **“UJESJELLES KANALIZIME SHA FUSHE KRUJE”.**

Ekspert kontabël te autorizuar për të kryer ketë mision dhe te gjitha modalitetet e bashkimit emërohet Ekspertja Kontabël e Regjistruar **Znj. Silvana Gjikdhima** me licence ne 162 date 25.01.2007 dhe **Znj. Vullnetare Cela** me licence nr 153

Shoqëria e përthithur **“UJESJELLES KANALIZIME SHA FUSHE KRUJE”** do te kaloje te gjitha pasuritë e saj tek shoqëria **“UJESJELLES KANALIZIME SHA KRUJE”.** Shoqëria përthithëse do të gëzojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që shoqëria e përthithur kishte në momentin e përthithjes.

Me bashkimin e shoqërive, shoqëria përthithëse është pronare 100% e shoqërise se përthithur.

Bashkimi i te dy shoqërive nuk sjell pasoja ne marrëdhëniet e punës te punëmarrësve.
Organet e administrimit të shoqërisë përthithëse kanë po ato të drejta dhe detyrime që kanë gëzuar përpara bashkimit të shoqërive.
Shoqëria përthithëse **“UJESJELLES KANALIZIME SHA KRUJE”** do të marrë në aktivin dhe pasivin e bilancit të saj, të gjitha aktivet dhe pasivet e shoqërise se përthithur **“UJESJELLES KANALIZIME SHA FUSHE KRUJE”** sipas bilancit të datës 30.08.2016 dhe të gjitha veprimet kontabël të kryera nga shoqërite e përthithura gjatë muajit shtator do të regjistrohen në kontabilitetin e shoqërisë përthithëse, pra atë të shoqërisë **“UJESJELLES KANALIZIME SHA KRUJE”.**

KRYETARI I BASHKISE

Artur BUSHI

Shoqëria“UJESJELLES KANALIZIME
SHA KRUJE” .
Administrator
Ledio Cela

ShoqëriaUJESJELLES KANALIZIME SHA
FUSHE KRUJE” .
Administrator
Xhemali Xhixha

Kruje më 02.02.2017.

RAPORTI I ADMINISTRATOREVE PER BASHKIMIN ME PERTHITHJE TE "UJESJELLES KANALIZIME SHA FUSHE KRUJE nga "UJESJELLES KANALIZIME SHA KRUJE "

- **Shoqëria përthithëse "UJESJELLES KANALIZIME SHA KRUJE"** , me kapital te nënshkruar 53.850.000 Lekë, të ndare ne 53,850 aksione te zakonshme te regjistruar me te drejte vote me vlere nomimale prej ALL 1000 leke
- **Shoqëria e përthithur "UJESJELLES KANALIZIME SHA FUSHE KRUJE** me kapital te nënshkruar 134.428.473 Lekë, të NDARE NE 1000 AKSIONE ME VLERE NOMIMALE 134.428,47 Leke.

Shoqëria **"UJESJELLES KANALIZIME SHA KRUJE "** dhe shoqëria **"UJESJELLES KANALIZIME SHA FUSHE KRUJE "**do te bashkohen ne nje shoqeri te vetme .Bashkim do te behet me përthithje, prandaj mbështetur në dispozitat e Ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", administratoret e shoqërive respektive përgatisin këtë raport për të detajuar bashkimin e shoqërive për ta paraqitur këtë pranë QKR.

Shoqëria**"UJESJELLES KANALIZIME SHA KRUJE "**

Shoqeria Ujesjelles Kanalizime Sha Kruje eshte krijuar me vendimin e gjykates se rrethit Tirane
Nr.21.400 AKT date 24.05.1999 dhe 21400/1 AKT per kanalizimet .me kaptal teresisht shteteror me
vlere aktuale 53.850.000 leke.Administrator I shoqerise eshte Z.Ledio Cela I miratuar me Vendimin e
Keshillit | Mbikqyres Nr. 4 Dt 04.02.2016 me seli prane shoqerise Ujesjelles-Kanalizime Sha Kruje,me
NIPT J 64713209J nga organi tatimor.

Shoqeria ka nje personel prej 70 nr.mesatar punonjesish ku kater persona prej tyre jane persona drejtues
drejtori,jurist dhe dy Drejtoret dega e tregtare dhe dega teknike.
Ne vendimin Nr 12 te dates 30.08.2016 mori ne shqyrtim materialin e paraqitur nga nderrmarja
nga kryetari I Bashkise Kruje ,mbeshtetur ne ligjin Nr 9901 te dates 14.04.2008" Per aksioneret dhe
shoqerite tregtare ,I ndryshuar ,VKM Nr 63 dt 27.01.2016 "Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne

sherbimin e furnizimit me uje te pijshem,grumbullimin,largimin,dhe trajnimin e ujrave te ndotur" dhe

vendimin e Keshillit te Administrimit Nr 12 date 30.08.2016 u vendos miratimi I struktures se re prej 70 puntoresh

,me perfaqesues te Asamblese se Aksionereve Z.Artur Bushi.

dhe Me kalimin e aksioneve 100 % Bashkise Kruje u be dhe emerimi I Keshillit te Administrimit te Ujesjelles

Kanalizime Sha Kruje sipas Vendimit te Asamblese se Aksionereve me keto persona:

Artur Cela Kryetar I Keshillit Administrimit
Athanas Karaj Aneter I KeshillitAdministrimit
Ledio Cela Anetar I KeshillitAdministrimit

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ekonomiko financiare ne perputhje me ligjin 9901 date 14.04.2008

1. "Per aksioneret dhe shoqerite Tregtare".Aktiviteti I saj eshte shitje e ujit te pishem dhe kanalizime.

Bashkëlidhur këtij raporti jane bilancet e plote kontabël për 3 vitet e fundit ushtrimore.

Shoqëria zbaton standardet kombëtare te kontabilitetit dhe Legjislacionin Tatimor ne fuqi.

Shoqëria zbaton parimet e kontabilitetit:

- Parimin mbi bazën e te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara.

Transaksionet dhe ngjarjet e tjera ekonomike janë njohur në pasqyrat financiare kur ato kanë ndodhur. Shpenzimet janë njohur në të njëjtën periudhë kontabël që janë marrë dhe të ardhurat që iu korrespondojnë atyre.

- Parimi i njësisë ekonomike.

Në pasqyrat financiare janë regjistruar aktivet, pasivet, kapitali, të ardhurat, shpenzimet, fluksi i parasë që i përkasin njësisë ekonomike.

- Parimi i mos kompensimit.

Shoqëria me përjashtim te kompensimeve qe lejon standarti kombëtar i kontabilitetit nuk ka bere kompensime midis aktiveve dhe pasiveve, te ardhurave dhe shpenzimeve.

- Parimi i kostos historike.

Pasqyrat financiare janë ndërtuar mbi bazën e kostos historike, pa bere rivleresime te aktiveve dhe as te pasiveve.

organi tatimor.

Metoda e përdorur ne lidhje me koston mbi aktivet dhe pasivet, aplikohet parimi i kostos historike.

Kontabiliteti mbahet i informatizuar nga persona të licencuar ne baze te kontratave te sherbimit. Organizimi i Kontabilitetit mbahet ne mënyre analitike, i cili shërben nevojave te kontrollit te performancës dhe analizave te brendshme ne mënyrë te kënaqshme.

Çdo veprim mbështet ne dokumenta ligjore justifikues dhe kontabilizohet ne afate optimale.

Metoda baze e mbajtjes se kontabilitetit, është regjistrimi i dyfishtë. Te paktën një here ne vit behet vlerësimi i ekzistencës se elementeve te aktivit dhe pasivit te bilancit.

Grupet kryesore të aktivit dhe të pasivit, sipas bilancit te vitit **2015** për shoqërinë **"UJESJELLES KANALIZIME SHA KRUJE "**

pasqyrohen si vijon:

a) AKTIVET Në total	1.104.585.089Lekë.
• Aktivet afatshkurtra ne vlerën neto	248.634.294 Lekë.
• Aktive afatgjata ne vlerën neto	855.950.795 Lekë.
b) PASIVET Në total	1.104.585.089Lekë.
• Pasivet afatshkurtra ne vlerën neto	53,202,3111 Lekë.
• Pasivet afatgjata ne vlerën neto	788,418,815 Lekë.
c) AKTIVET neto në vlerën	18.089.377 Lekë.

Bilanci dhe pasqyrat financiare mbahen ne Lekë shqiptare. Gjatë vitit operohet dhe në monedha të huaja. Në fund të vitit behet rregullimi përkatës i monedhave me kursin e fundit të vitit.

1. Shoqëria **"UJESJELLES KANALIZIME SHA FUSHE KRUJE "**

Shoqeria Ujesjelles- Kanalizime Sha Fushe Kruje eshte krijuar me vendimin e gjykates se rrethit Tirane

Nr.24077 date 20.06.2000 me kaptal teresisht shteteror me vlere aktuale 134.428.473 leke.Administrator I shoqerise eshte Z.Xhemali Xhixha me seli DURRES,FUSHE KRUJE, Fushe Kruje Qender,me NIPT J93711212U nga organi tatimor.

Keshilli mbikqyres perbehet nga :
Alket Hyseni Kryetar
Athanas Karaja Anetar
Dario Zherri Anetar

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ekonomiko financiare ne perputhje me ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per aksioneret dhe shoqerite Tregtare".Aktiviteti I saj eshte eshte :

Sherbimi i furnizomit me uje te pijshem dhe shitja e tij.Mirembajtja e sistemeve te furnizimit me uje te pijshem.

Prodhimi ose blerja e ujit per plotesimin e kerkesave te konsumatoreve.Sherbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit te ujrave te ndotura. Mirembajtja e sistemit te ujrave te ndotura si edhe impiantev ete pastrimit te tyre.

Shoqeria mund te realizoje cdo lloj operacioni tregtar apo financiar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj brenda limiteve qe percakton legjistacioni ne fuqi. Shoqeria do te kryej cdo veprim me qellim marjen e lejeve ,licencave , autorizimeve dhe miratimeve te nevojshme per realizimin e veprimtarise se saj per te cilat kerkohen keto akte administrative.

Shoqëria zbaton standardet kombëtare te kontabilitetit dhe Legjislacionin Tatimor ne fuqi.

Shoqëria zbaton parimet e kontabilitetit:

- Parimin mbi bazën e te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara.

Transaksionet dhe ngjarjet e tjera ekonomike janë njohur në pasqyrat financiare kur ato kanë ndodhur. Shpenzimet janë njohur në të njëjtën periudhë kontabël që janë marrë dhe të ardhurat që iu korrespondojnë atyre.

- Parimi i njësisë ekonomike.

Në pasqyrat financiare janë regjistruar aktivet, pasivet, kapitali, të ardhurat, shpenzimet, fluksi i parasë që i përkasin njësisë ekonomike.

- Parimi i mos kompensimit.

Shoqëria me përjashtim te kompensimeve qe lejon standarti kombëtar i kontabilitetit nuk ka bere kompensime midis aktiveve dhe pasiveve, te ardhurave dhe shpenzimeve.

- Parimi i kostos historike.

Pasqyrat financiare janë ndërtuar mbi bazën e kostos historike, pa bere rivleresime te aktiveve dhe as te pasiveve.

Metoda e përdorur ne lidhje me koston mbi aktivet dhe pasivet, aplikohet parimi i kostos historike.

Kontabiliteti mbahet i informatizuar nga persona të licencuar ne baze te kontratave te sherbimit. Organizimi i Kontabilitetit mbahet ne mënyre analitike, i cili shërben nevojave te kontrollit te performancës dhe analizave te brendshme ne mënyrë te kënaqshme.

Çdo veprim mbështet ne dokumenta ligjore justifikues dhe kontabilizohet ne afate optimale.

Metoda baze e mbajtjes se kontabilitetit, është regjistrimi i dyfishtë. Te paktën një here ne vit behet vlerësimi i ekzistencës se elementeve te aktivit dhe pasivit te bilancit.

2. Grupet kryesore të aktivit dhe të pasivit, sipas bilancit te vitit **2015** për shoqërise **"UJESJELLES KANALIZIME SHA FUSHE KRUJE "** pasqyrohen si vijon:

d) AKTIVET Në total	64.597.141 Lekë.
• Aktivet afatshkurtra ne vlerën neto	53.114.566 Lekë.
• Aktive afatgjata ne vlerën neto	11.482.775 Lekë.
e) PASIVET Në total	64.597.141 Lekë.
• Pasivet afatshkurtra ne vlerën neto	33.397.654Lekë.
• Pasivet afatgjata ne vlerën neto	2.109.961Lekë.
f) AKTIVET neto në vlerën	29.089.526 Lekë.

Bilanci dhe pasqyrat financiare mbahen ne Lekë shqiptare. Gjatë vitit operohet dhe në monedha të huaja. Në fund të vitit behet rregullimi përkatës i monedhave me kursin e fundit të vitit.

1. <u>Drejtimi i Bashkimit:</u>

Ne këtë operacion bashkimi shoqëria **"UJESJELLES – KANALIZIME KRUJE" SH.A** qe do te jete shoqëria përthithëse, e shënuar ne vijim si shoqëria përfituese e kontributeve dhe shoqëria **"UJESJELLES – KANLIZIME FUSHE KRUJE" SH.A** shoqëri e përthithur, e shënuara ne vijim si shoqëri kontribuese.

2. Motivet dhe qëllimet e bashkimit.

Motivi i bashkimit të shoqërive **"UJESJELLES – KANALIZIME KRUJE" SH.A** dhe shoqërise **"UJESJELLES – KANLIZIME FUSHE KRUJE" SH.A eshte VKM 63 dt 27.01.2016 " Ligji 139/2015 Per vetqeverisjen vendore , Ligji 9723 dt**

3.05.2007 "Per qendren Kombetare te Biznesit (I ndryshuar) , ligjit 115/2014 Per ndarjen administrative teritoriale te njesive te qeverisjes vendore , Vendimi i keshillit Bashkiak Kruje nr 51 dt 31.08.2016 ." Per miratimin e ndryshimeve te Aksioneve te Ujesjelles –Kanalizimeve sha Kruje.

3. Aktivet dhe pasivet (detyrimet) e parashikuara për tu transferuar.

Ne kuadër te këtij operacioni bashkimi, parashikohet qe shoqëria e përthithur **"Ujesjelles - Kanalizime sha Fushe Kruje** do te transferoj (kaloj) tek shoqëria përthithëse **"Ujesjelles –Kanalizime sha Kruje** tërësinë e elementeve te aktivit dhe te pasivit, duke përfshirë edhe ato qe rezultojnë nga operacionet e kryera qe nga data 01.10.2016.

Ne aspektin kontabël, te gjitha transaksionet e kryera nga shoqëria e përthithur "Ujesjelles – Kanalizime sha Fushe Kruje qe nga data 01.10.2016 e ne vazhdim do te regjistrohen si transaksione te shoqërisë përthithëse, pra te shoqërisë "Ujesjelles – kanalizime sha Kruje.

Shoqëria **"Ujesjelles – kanalizime sha Kruje** do te jete zotëruese e kontributit te shoqërise **"Ujesjelles – Kanalizime sha Fushe Kruje** ne datën e realizimit përfundimtar te operacionit te bashkimit.

Shoqëria **"Ujesjelles- kanalizime sha kruje** gëzon frutat e kontributit te përfituar duke filluar nga data 01.10.2016 me kushtin e realizimit te bashkimit ne fjale.

Kapitali i nënshkruar mbas bashkimit është ne vlerën 188.278.473 (njeqindetetedhjeteetetemilionedyqindeshtatedhjeteetetemijeekaterqindeshtatedhjeteetre) Lekë e cila perfaqeson 1 (nje) kuote me vleren totale 188.278.473 (njeqindetetedhjeteetetemilionedyqindeshtatedhjeteetetemijeekaterqindeshtatedhjeteet

re) Lekë dhe zotërohet nga Bashkia Kruje .

Ndaj punonjësve te dy shoqërive pasojat e bashkimit janë te pa konsiderueshme. Punonjësit ne përgjithësi do te kenë po ato vende pune dhe page te njëjtë.

Data kontabël : Ne aspektin e kontabilitetit te gjitha operacionet e veprimtarisë te kryera prej shoqërisë **"Ujesjelles – Kanalizime sha Fushe Kruje** nga 01.10.2016 e deri ne datën e realizimit te bashkimit do te konsiderohen si te kryera nga shoqëria **"Ujesjelles – kanalizime sha Kruje** dhe regjistrimet kontabile do te mbahen ne librat e kësaj te fundit.

Data e përgatitjes (hartimit) te llogarive : Llogaritë qe janë përdorur për te përcaktuar kushtet financiare te bashkimit janë hartuar duke iu referuar datës 30.09.2016 si për shoqërinë përthithëse dhe për shoqërinë e përthithur.

Bashkëlidhur është bilanci i bashkimit te shoqërive i datës se bashkimit 30.09.2016.

Raportet e këmbimit : Meqenëse ortaket e shoqërisë përthithëse janë te njëjtë dhe me te njëjtat te drejta dhe detyrime ndaj shoqërise se përthithur nuk është e nevojshme për analiza lidhur me raportet e këmbimit te kuotave pasi kapitalin e nënshkruar te shoqërisë se përthithur e zotëron 100% shoqëria përthithëse qe ka për aksioner Bashkine Kruje (prone shteterore), si te tilla janë vlerësuar ne nivele te njëjta me te njëjtën vlere qe është ne bilanc dhe perfaqesojne nje kuote qe i përkasin aksionerit te shoqërisë përthithëse.

Shoqëria "UJESJELLES
KANALIZIME SHA
KRUJE

Shoqëria "UJESJELLES
KANALIZIME SHA
FUSHE KRUJE.

Administrator

Ledio Cela

Administrator

Xhemali Xhixha

KRYETARI I BASHKISE

Artur BUSHI

Kruje me, 03.02.2017

RAPORT MBI PERTHITHJEN (BASHKIMIN) E UJESJELLES KANALIZIMEVE SHA FUSHE KRUJE ME UJESJELLES - KANALIZIME SHA KRUJE

Tirane, 03.02.2017

PERMBAJTJA

Raport i Eksperteve Kontabel te Regjistruar (EKR)

Informacione te Pergjithshme

- ***I. Referenca Ligjore***
- ***II. Realizimi i misionit per verifikimin e procedurave te perthithjes (bashkimit) te Ujesjelles – Kanalizime sha Fushe Kruje me Ujesjelles – Kanalizime sha Kruje .***
- *III.* ***Vleresimi i Kapitalit te Ujesjelles – Kanalizime sha Kruje***

Dokumente mbeshtetese:

- Pasqyrat Financiare individuale te Ujsjelles – kanalizime sha Fushe Kruje dhe Ujesjelles –

kanalizime sha Kruje .

- Procesverbalet e inventareve fizik te dates 30/09/2016
- Rregjistri i aktiveve afatgjata materiale
- Lista e Klienteve dhe Kreditoreve
- Lista e debitoreve
- Situacionet e Komunes thumane
- Liste asetesh te Bubqit

RAPORT I EKSPERTEVE KONTABEL TE REGJISTRUAR MBI PERTHITHJEN (BASHKIMIN) E UJESJELLES – KANALIZIME SHA FUSHE KRUJE NGA UJESJELLES – KANALIZIME SHA KRUJE

Ky mision eshte kryer ne pajtim me SNA-te (Standardet Nderkombetare te Auditimit) te publikuara nga IAASB (Bordi i Standardeve Nderkombetare te Auditimit dhe Sigurise) te IFAC (Federates Nderkombetare te Kontabilisteve).

Raporti yne nuk synon te jetę gjitheperfshires, por te theksoje dhe te sjelle ne vemendjen tuaj çeshtje kryesore te caktuara sipas qellimit te punes te rene dakort.

Raporti eshte konfidencial per Ju, sikunder eshte rene dakort, dhe eshte subjekt i limitimeve ne perdorim, specifikuar ne kontrate. Palet e treta, perveç atyre te permendura ne kontrate, mund ta zoterojne materialin kundrejt firmosjes se Letres se Pademshmerise. Ne nuk mbajme asnje pergjegjesi kundrejt çdo pale ne lidhje me permbajtjen e Raportit.

Si rezultat i kufizimeve, kohes ne dispozicion, informacionit dhe/apo aksesit, ne mund te mos kemi identifikuar te gjitha faktet apo informacionin e nevojshem per Sherbimin apo ato qe Ju mund ti konsideroni si te rendesishme.

Ne keto rrethana, ne mund te mos jemi plotesisht ne dijeni te fakteve apo informacionit qe Ju konsideroni te rendesishem. Rrjedhimisht, ne nuk mbajme asnje pergjegjesi mbi besueshmerine, saktesine, plotesine apo keqinterpretimin e informacionit apo çeshtje qe nuk mbulohen ne Raport apo qe rrjedhin si pasoje e natyres se limituar te punes sone.

Përgatitja e deklarimeve financiare, juridike eshtë përgjegjësi e drejtimit të Ujesjelles – Kanalizime sha Fushe Kruje dhe Ujesjelles – Kanalizime sha Kruje për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre informacioneve te domosdoshme per dhenien e sigurise se procesit te perthithjes se ujesjelles – kanalizime sha Fushe Kruje nga Ujesjelles – Kanalizime sha Kruje.

Përgjegjësia e Eksperteve Kontabel të Regjistruar (EKR) është të formojme një opinion të pavarur mbi këte proces, bazuar në verifikimet tona.

Nga ana jone realizimi i ketij misioni per procesin e perthithjes se Ujesjelles – Kanalizime sha Fushe Kruje nga Ujesjelles – Kanalizime sha Kruje me date 30 shtator 2016, sipas vleres kontabel te Pasqyrave Financiare individuale te Ujsjelles – kanalizime

sha Fushe Kruje nga Ujsjelles – Kanalizime sha Kruje, ne daten 30.09.2016 rezulton si me poshte :

i. Perthithjen (bashkimin) e aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit si me poshte:
   - Ujesjelles - Kanalizme sha Fushe Kruje
   - Ujesjelles - Kanalizme sha Kruje

ii. Sistemimin perfundimtar te vleresimit te aktiveve, detyrimeve dhe Kapitalit te:
   - Ujesjelles - Kanalizme sha Fushe Kruje
   - Ujesjelles - Kanalizme sha Kruje

Per realizimin e ketij misioni ne e perqendruam punen tone per verifikimin e procedurave te ndjekura per perthithjen (bashkimin) e Aktiveve, Detyrimeve dhe Kapitalit Ujsjelles – Kanalizime sha Fushe Kruje nga Ujesjelles Kanalizime sha Kruje ne:

✓ Verifikimin mbi bazën e dokumentave juridikë, te inventareve kontabël dhe te evidencave te tjera te domosdoshme që mbështesin shumat dhe informacionet e dhëna në Pasqyrat Financiare individuale te dates 30.09.2016 te Ujesjelles – Kanalizime sha Fushe Kruje te perthithur nga Ujesjelles – Kanalizme sh.a Kruje.

✓ Verifikimi i inventareve fizike te Aktiveve Afatgjate Materiale (AAM) dhe te Aktiveve ne Magazine (AM) qe mbështesin shumat dhe informacionet e dhëna Ujesjelles – Kanalizime sha Fushe Kruje dhe Ujselles - Kanalizime sha Kruje.

✓ Vendodhjen e AAM-ve (Aktiveve Afatgjate Materiale) dhe te AM-ve (Aktiveve ne Magazine).

✓ Perthithjen (bashkimin) e ketyre Aktiveve nga Ujsjelles – kanalizime sha Kruje si me poshte te :

- Ujsjelles kanalizime sha Fushe Kruje

✓ Vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të Pasqyrave Financiare te dates 30.09.2016 te perthithura (bashkuara) te Ujesjelles – Kanalizime sha Fushe Kruje me Ujsjelles Kanalizime sha Kruje si dhe percaktimin e kapitalit per kete shoqeri.

✓ Vleresimin dhe pasqyrimin ne bilancin e perthithjes (bashkimit) te Ujsjelles kanalizme sha Fushe kruje nga Ujesjelles – Kanalizime sha Kruje te aseteve qe nuk kane qene pasqyruar .

✓ Verifikimin e listes se debitoreve, kreditore dhe aseteve te Ujsjelles kanalizime sha Fushe Kruje I cili do te perthithet nga ujsjelles – Kanalizme sha Kruje.

Pas verifikimit të të gjithë procesit dhe dokumentacionit të përshkruar më sipër, mbi bazën e të cilëve eshte percaktuar vlera e kapitalit te Ujesjelles – Kanalizme sha Kruje pas perthithjes se Ujesjelles Kanalizime sha Fushe Kruje eshte organizuar perthithja e ketyre 2 (dy) shoqerive aksionere si me poshte:

- Shoqeria Ujesjelles – Kanalizime sha Kruje sha ka kapitalin themeltar aksioner 53,850,000 leke
- Shoqeria Ujesjelles – Kanalizime sha Fushe Kruje ka kapitalin themeltar aksioner 134,428,473 leke .
- Shoqeria Ujesjelles – Kanalizime sha Kruje pas perthithjes ka kapitalin themeltar aksioner 188,278,473 leke

Pas verifikimit te procedurave te perthithjes se Ujesjelles – Kanalizime sha Fushe Kruje nga Ujesjelles – Kanalizime sha Kruje :

REKOMANDOJME:

- ✓ Ne baze te ketij Raportit te Posacem, aplikimin dhe kryerjen e veprimeve ne Qendren Kombetare te Biznesit, sipas vleres se paraqitur ne raport.
- ✓ Vazhdimin e vijueshmerise se Pasqyrave Financiare individuale te shoqerise Ujesjelles – Kanalizime sha Kruje dhe perthithja e shoqerise Ujesjelles – Kanalizime sha Fushe Kruje dhe perfundimi i procesit te bashkimit.
- ✓ Sistemimin perfundimtar te aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit te Ujesjelles – Kanalizime sha Kruje ne daten e hyrjes ne fuqi te perthithjes (bashkimit) .
- ✓ Njoftimet per bashkimin e Ujesjelles – Kanalizime Fushe Kruje me Ujesjelles – Kanalizime Kruje ne Drejtorite Rajonale Tatimore dhe ne te gjitha institucionet perkatese rregullatore.

- ✓ Lidhur me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme te ndiqen procedurat e aplikimit ne institucionet perkatese, me hyrjen ne fuqi te perthithjes.

Ky raport hartohet ne 3 (tre) kopje nga te cilat 3 (tre) kopje dorezohen prane Ujesjelles – Kanalizime Kruje sh.a.

GRUPI I EKSPERTEVE KONTABEL TE REGJISTRUAR

Eksperte Kontabel e Regjistruar

Vullnetare Hoxha (Çela)
Lic. Nr. 153

VULLNETARE ÇELA (HOXHA)
NIPT: K 71527001Q
Liçensë Nr.153

Sivana Gjikdhima
Lic. Nr.162

SILVANA GJIKDHIMA
E.K.A LIÇENS NR 162
NIPT K 32202008 F

INFORMACIONE TE PERGJITHSHME TE UJESJELLES – KANALIZIME SHA KRUJE

Shoqeria Ujesjelles Kanalizime Sha Kruje eshte krijuar me vendimin e gjykates se rrethit Tirane Nr.21.400 AKT date 24.05.1999 dhe 21400/1 AKT per kanalizimet me kaptal teresisht shteteror me vlere aktuale 53.850.000 leke. Administrator i shoqerise eshte Z.Ledio Cela i miratuar me Vendimin e Keshillit Mbikqyres Nr. 4 Dt 04.02.2016 me seli prane shoqerise Ujesjelles-Kanalizime Sha Kruje, me NIPT J 64713209J nga organi tatimor.

Shoqeria ka nje personel prej 70 nr.mesatar punonjesish ku kater prej tyre jane persona drejtues (drejtori,juristi dhe drejtori i Deges tregtare dhe drejtrori i Deges teknike). Ne vendimin Nr.12 te dates 30.08.2016 mori ne shqyrtim materialin e paraqitur nga nderrmarja,nga kryetari i Bashkise Kruje, mbeshtetur ne ligjin Nr.9901 te dates 14.04.2008 " Per aksioneret dhe shoqerite tregtar ,i ndryshuar ,VKM Nr 63 dt 27.01.2016 "Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem,grumbullimin,largimin, dhe trajnimin e ujrave te ndotur" dhe vendimin e Keshillit te Administrimit Nr.12 date 30.08.2016 u vendos miratimi i struktures se re prej 70 punetoresh , me perfaqesues te Asamblese se Aksionereve Z.Artur Bushi dhe me kalimin e aksioneve 100 % Bashkise Kruje. Gjithashtu u be dhe emerimi i Keshillit te Administrimit te Ujesjelles Kanalizime Sha Kruje sipas Vendimit te Asamblese se Aksionereve me keto persona:

Artur Cela	Kryetar i Keshillit Administrimit
Athanas Karaj	Aneter i Keshillit Administrimit
Ledio Cela	Anetar i Keshillit Administrimit

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ekonomiko-financiare ne perputhje me ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per aksioneret dhe shoqerite Tregtare". Aktiviteti i saj eshte shitje e ujit te pijshem dhe kanalizime.

Shoqeria per miratimin e bilancit kontabel viti 2016 eshte bazuar ne Ligjin Nr.8438 dt 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat" i ndryshuar ,Udhezimit te Ministrit te Financave

Nr.5dt 30.01.2006 "Per tatimin mbi te ardhurat" i ndryshuar,VKM Nr.922 dt 29.12.2014 "Per deklarimin e detyrueshem te deklaratave tatimore dhe te dokumentave te tjera tatimore ,vetem nepermjet formes elektronike" si dhe kerkesave te ligjit Nr.9228 date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar dhe sipas njoftimit nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve per dorezimin e pasqyrave financiare per vitin fiskal 2016.

